
STATUTI i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “Angel’s Distribution” SH.P.K.

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqi me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” I azhornuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” –Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

KREU I Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Me date **13.01.2021** une e nenshkuara: **Rudina Turtulli**, shtetase shqiptare, mbajtëse e kartes se identitetit **H65520077N**; po regjistroj nje shoqi me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Angel’s Distribution”**, bazuar ne aktin e themelimit te saj date **13.01.2021**.

Neni 2

Objekti i shoqerise :

2.1

Shoqeria do te kete si objekt ushtrimin e te gjitha veprimtarive ne fushen e kozmetikes dhe ushqimit.

Importimi, eksportimi, prodhimi, shitja, shperndarja, marketingu i sherbimeve kozmetike, ushqimore dhe ofrimi i sherbimeve ne sektorin kozmetik dhe ushqimor ndaj te treteve. Importi, eksporti, shitja, shperndarja, prodhimi dhe tregimi me shumice e pakice te produkteve kozmetik (biokozmetik dhe dermokozmetik), shtesa ushqimore. Importimi, eksportimi, prodhimi, shitja, shperndarja, tregetimi i prodhimeve kozmetike dhe estetike, si dhe i artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, buqesore, blegtorale.



Gjithashtu, objekt i veprimtarise se shoqerise eshte blerja e aseteve ne Shqiperi ose jasht vendit, te cdo shoqerie ose sipermarrje ne cfareolloj forme si dhe menaxhimi i ketyre aseteve.

Shoqeria mund te marri pjese krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe drejtimin e cfareolloj shoqerie ose sipermarrje. Gjithashtu, mund te perfitoj me ane te kontributeve, dhe blerjeve, patenta, marka sherbimi, licenca per patenta ekskluzivite, njojuri, informacion konfidential dhe te drejta te tjera pronesie industriale, tregtare ose intelektuale, dhe ne per gjithesi te posedoje, te lisensoje ose te transferoje keto te drejta, te shesi ose te disponoje mbi to, ne teresi ose pjeserisht, per qellime te cilat shoqeria konsideron te pershatshme dhe te nenshkruaj kontrata me kontraktor ose nenkontraktor per menaxhimin, zhvillimin, licencimin e ketyre te drejtave perfshire edo lloj patente, marke, shenje dalluese dhe licence dhe te marri dhe te kryej regjistrimet e ketyre te drejtave perkatesisht.

Gjithashtu, shoqeria mund te ndermarri cfareolloj veprimi te nevojshem per mbrojtjen e te drejtave qe rrjedhin nga ekskluziviteti, patenta, marka, shenja dalluese, licenca, nenlicenca, njojurie, informacione konfidentiale dhe te drejta te tjera pronesie industriale, tregtare dhe intelektuale ose te drejta te ngjashme me keto, nga shkelje, shperdorim, perdonim te paautorizuar nga pale te treta.

Gjithashtu shoqeria mund te ushtroj edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te pasqyrehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**Neni3
Kohezgjatja**

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

4.1. Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Rruga "Hasan Vogli" pallati "SHERON"

**KREU II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali themeltar**



5.1 Kapitali fillestari i kompanise do te 100.000(njeqindmije) leke te ndare ne lkuote me vlore nominale 100 000 leke per kuote e cila zoterohet nga ortaku i vetem **Rudina**

Turtulli

5.2. Kontributi i ortakeve mund te jetë ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimave te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimice.

KREU III Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrer i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:

- a) peraktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) peraktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - g) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
- 8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

9.1. Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkresce ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkresce apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) gritet e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

13.1. Asambleja e per gjithshme emeron një ose me shumë persona fizike si administratoret shoqerise. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejtë riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administratoret e një shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emerohen si administratore të një shoqerie të kontrolluar e anasjellta. Çdo emerim i bere në kundershtim me keto dispozita është i pavlefshëm.

13.3. Znj. **Xhilda Bardhi** është Administratore e shoqerise deri në emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejne të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojnë shoqerine tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, që kereenojne mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne të dhenat e detyrueshme të shoqerise, siç parashikohet në ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- e) raportojnë perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendesi të veçante per veprimtarinë e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

14.2. Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblec e Pergjitheshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerise nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve të vazhdimit.
- shoqeria propozon të shese apo të disponoje në menyre tjeter aktive, të cilat kane një vlerë me të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqerise, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerishit shoqerine.

14.4. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) te krye detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arrijen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me per gjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

c) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

15.3.3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij nenit, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.



15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'I demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plete te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin finanziar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV **Viti finanziar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

16.1. Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejttes vendimore qe ka.

KREU V



Prishja –riorganizimi i shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuuar ne themelin e saj;

b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

c) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjt "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Rudina Turtulli

Rudina Turtulli R